



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1437/4prot

Datë 12.08.2022

V E N D I M
Nr. 781/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Joanid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.08.2022, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Euromega 2010” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-32147-06-08-2022, me objekt: “Blerje materiale pastrimi dhe detergjente, Bashkia Kurbin”, me fond limit 2,416,667 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 20.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kurbin.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Malvina Visoka” pf në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik LEON Group në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Anbin” ShPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

“ATLANTIK 3” SHPK
Autostrada Tirane - Durrës, Km. 10, Rruga dytësore Vorë
Tiranë

“Malvina Visoka” pf
Rruga “Muhamet Veliu”, Pallati ILIAD, Shkalla 1, Kati 1,
Dajt Linzë Tiranë

LEON Group
Adresa: Bulevardi Blu , Pallati Blu Nr.11, Kati 1

“Anbin” ShPK
Adresa: Rruga: “Muhamet Gjollësja”, Pallati 30, Shkalla3,
Ap.20 Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Kurbin
Lagjja Nr.3, Laç

Subjekte të interesuar:

“EURO MEGA 2010” SHPK
Tiranë Prezë Fshati Ahemtaq, pranë firmës Ital Kon, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021,

datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 09.06.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-32147-06-08-2022, me objekt: “Blerje materiale pastrimi dhe detergjente, Bashkia Kurbin”, me fond limit 2,416,667 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 20.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kurbin.

II.2. Në datën 20.06.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.2. Në datën 29.06.2022 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Leon Group” SHPK	1.242.916,7 lekë, skualifikuar
2. “Anbin” SHPK	1.457.750 lekë, skualifikuar
3. “Capital Group” SHPK	1.949.300 lekë, skualifikuar
4. “Euro mega 2010” SHPK	1.990.000 lekë, kualifikuar
5. “Malvina Visoka” SHPK	2.185.500 lekë, skualifikuar
6. “Atlantik 3” SHPK	2.395.000 lekë, kualifikuar

II.3. Në datën 04.07.2022, autoriteti kontraktor ka publikuar **njoftimin e fituesit** për procedurën e prokurimit në sistemin elektronik të prokurimeve.

II.4. Në datën 05.07.2022, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1437/2022 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2333 e operatorit ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK, duke kërkuar skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Euro mega 2010” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.4.1. Në ankesë ngrihen pretendime nga ana e operatorit ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK si më poshtë vijon:

[...] Operatori ekonomik “Euromega 2010” ShPK nuk plotëson kriteret për kualifikim pasi ka mungesë dokumentacioni dhe nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara në DST. Ky operator ekonomik nuk përmbush specifikimet teknike të produkteve sipas shtojcës 5 për artikujt e kërkuara si mostra ditën e zhvillimit të procedurës dhe skedat teknike të produkteve sipas shtojcës 5 për artikujt e kërkuara në dst.

1 Detergjent neutral dyshemeje – Për këtë produkt i mungon etiketimi në përputhje me rregulloren CE nr. 1272/2008, mostra e paraqitur nuk është sipas etiketimit të kërkuar, gjithashtu edhe skeda për këtë produkt nuk është konform etiketimit me rregulloren CE nr. 1272/2008, skeda teknike nuk është e standardizuar dhe nuk është e regjistruar në faqen zyrtare të uebit.

2. Detergjent për larje xhamash dhe kristale- Për këtë produkt i mungon etiketimi në përputhje me rregulloren CE nr. 1272/2008, mostra e paraqitur nuk është sipas etiketimit të kërkuar, gjithashtu edhe skeda për këtë produkt nuk është konform etiketimit me rregulloren CE nr. 1272/2008, skeda teknike nuk është e standardizuar dhe nuk është e regjistruar në faqen zyrtare të uebit.

3. Sapun Larje duarsh (lëng) Për këtë produkt i mungon etiketimi në përputhje me rregulloren CE nr. 1272/2008, mostra e paraqitur nuk është sipas etiketimit të kërkuar, gjithashtu edhe skeda për këtë produkt nuk është konform etiketimit me rregulloren CE nr. 1272/2008, skeda teknike nuk është e standardizuar dhe nuk është e regjistruar në faqen zyrtare të uebit.

4. Detergjent universal (zbardhues) Për këtë produkt i mungon etiketimi në përputhje me rregulloren CE nr. 1272/2008, mostra e paraqitur nuk është sipas etiketimit të kërkuar, gjithashtu edhe skeda për këtë produkt nuk është konform etiketimit me rregullore CE nr. 1272/2008, skeda teknike nuk është e standardizuar dhe nuk është e regjistruar në faqen zyrtare të uebit.

5. Sgrasante universal Për këtë produkt i mungon etiketimi në përputhje me rregulloren CE nr. 1272/2008, mostra e paraqitur nuk është sipas etiketimit të kërkuar, gjithashtu edhe skeda për këtë produkt nuk është konform etiketimit me rregullore CE nr. 1272/2008, skeda teknike nuk është e standardizuar dhe nuk është e regjistruar në faqen zyrtare të uebit.

6. Hipoklorit Kalciumi : Për këtë produkt i mungon skeda teknike certifikata e origjinës dhe autorizimi distributorit, këto dokumente i ka plotësuar dhe deklaruar vet, por hipokloriti i kalciumi është një produkt që nuk prodhohet në Shqipëri, dhe nuk e prodhon asnjë nga prodhuesit vendas të vendit tonë. Pra për këtë produkt ka mangësi dokumentacioni.

Në dst e tenderit në pikën 2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim është kërkuar që për produktet e tabelës të paraqiten këto dokumente:

2.6 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

a) Autorizim Prodhesi dhe/ose Kontratë Furnizimi/Bashkëpunimi nga një Distributor i Autorizuar per solucionet dhe detergjentet. Autorizimi apo Kontrata duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit apo kontraktuesit (Distributor i Autorizuar) si: telefon, fax, e-mail, website, shoqëruar me:

- Certifikate Origjine, konformiteti i mallrave sipas bashkimit europian.
- Operatori ekonomik duhet te paraqese (skeda teknike) per te gjithë artikujt e tabelës se meposhtme, skedat te jene te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe te jene te noterizuara njesi me origjinalin.

Nr. sipas Preventivit	Emertimi
5	Detergjent neutral dyshemeje (bidon 5 lit)
7	Detergjent per xhama dhe kristale (bidon 5 lit)
17	Sapun per larje duarsh (leng) (bidon 5 lit)
19	Detergjent universal (zbardhues) (bidon 5 lit)
20	Sgresante universal (bidon 5 lit)
21	Hipoklorit Kalciumi 55-70 %

Pra sa u përket këtyre dokumenteve operatori "Euromega 2010" ShPK nuk plotëson dokumentacionin për skedat teknike pasi skedat teknike i formulon vetë, pra nuk ka asnjë skedë të standardizuar dhe nuk i ka skedat teknike të etiketuara Konform Rregullores CE 1227/2008 siç janë kërkuar dhe për lëndën hipoklorit Kalciumi ka mungesë dokumentacioni pasi është një produkt që nuk prodhohet këtu, dhe dokumentet e plotësuar nga vete ky operator bien poshtë. Ju lutem verifikoni skedat teknike dhe mostrat e këtij operatori pasi nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Specifikimet teknike të kërkuara sipas DST janë:

Detergjent neutral dyshemeje – Te jete i perdorshem per larje dyshemeje, te jete i lengshem. Te permbaje substance. Shume aromat per pastrim te shpejte dhe pa veshtiresi te dyshemese duke hequr gjithë njollat e mundshme dhe te jete shume i shpejte ne tharje si produkt per te mos lene gjurme dhe aromat kete rreshkitje, ambalazh 5 lit . Etiketimi ne perputhje me rregulloren CE , nr. 1272/2008 te kete date prodhimi dhe date skadimi jo me pak se 1 vit.

Detergjent per larje xhamash dhe kristale- Te jete produkt shume i perqendruar, leng ne ngjyre te hapur dhe te mos leri njolla ne xham gjate perdorimit. Te jete i perdorshem me te gjitha llojet e fibrave te tekstilit. Te japi nje shkelqim xhamit dhe te thahet shpejte, i ambalazhuar ne ene plastike 5 lit. Etiketimi ne perputhje me rregulloren CE , nr. 1272/2008 te kete date prodhimi dhe date skadimi jo me pak se 1 vit.

Sapun larje duarsh leng -Te jete cilesore. Tu jape duarve butesi dhe arome te kendshme freskie. Te jete jo alergjik per lekuren, ambalazhi 5 lit. Etiketimi ne perputhje me rregulloren CE nr. 1272/2008 te kete date prodhimi dhe date skadimi jo me pak se 1 vit.

Detergjent universal (zbardhues) - Te jete cilësor, me fuqi larese te njollave. Ambalazhimi 5lit, gjendja fizike te jete leng. Te jete i tretshem ne uje. Te mos mbaje arome te forte dhe mos te demtoje lekuren e njeriut. Etiketimi ne perputhje me rregulloren CE , nr. 1272/2008 te kete date prodhimi dhe date skadimi jo me pak se 1 vit.

Sgrasante universal -Te jete me veti per heqjen e yndyrnave ambalazhi 5 lit. Etiketimi ne perputhje me rregulloren CE , nr. 1272/2008 , te kete date prodhimi dhe date skadimi jo me pak se 1 vit.

Hipoklorit Kalciumi – Te jete klori aktiv 55-70%, plumbi (pb) 2.2, kadmiumi (cd), kromi (Cr) 1.7, nikeli (ni) 1.9, per pastrim dhe dezinfektim te ambienteve te ndryshme.

Që një oe të kualifikohet duhet ti përmbush të gjitha kriteret e veçanta dhe të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në dst.

Pra ky ofertues nuk i përmbush këto kriteret për kualifikim duke patur mungesë dokumentacioni dhe mospërputhje të specifikimeve për këto produkte.

KVO për këtë procedurë prokurimi ka shkelur rregullat dhe ligjin e prokurimit publik, duke kualifikuar një oe që nuk arrin të përmbushë kriteret e veçanta për këtë objekt prokurimi, duke e favorizuar këtë oe padrejtësisht pasi artikujt duhet të jenë të njëjtët artikuj sipas autorizimit të prodhuesit sipas skedës teknike orgjinës dhe të plotësojnë të gjitha specifikimet e kërkuara sipas etiketimit CE1272/2008 të kërkuar në shtojcën 5.

Duke qenë në këto kushte kompania jonë kërkon skualifikimin e këtij oe pasi është kualifikuar padrejtësisht.

Për sa u tha më sipër”

Atlantik 3 ShPK drejton ankesë për skualifikimin e këtij operatori duke qenë se nuk përmbush kriteret për kualifikim dhe në këtë mënyrë AK nuk duhet të lejojë diskriminimin dhe favorizim të pabarazisë në tender, pasi në këtë mënyrë rritet konkurrenca, cilësia e rezultateve cilësia e shërbimit etj. Ju bëjmë me dije se kualifikimi i këtij oe është haptazi në shkelje të LPP-së dhe diskriminuese. Sa më lart duke u mbështetur në fakte dhe prova kërkojmë skualifikimin e operatorit

ekonomik “Euromega 201” ShPK duke qenë se ky oe nuk i përmbush kriteret e veçanta dhe specifikimet teknike në këtë procedurë.

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1437/2 datë 06.07.2022, lidhur me kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “ATLANTIK 3” SHPK, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Euro mega 2010” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Me shkresën nr.3006/20 prot., datë 15.07.2022, protokolluar me tonën nr.1437/3 prot., datë 18.07.2022, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, duke dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin mbi procedurën e prokurimit objekt-ankimi dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Atlantik 3” ShPK dhe ka vendosur mospranimin të ankesës.

II.7. Në datën 29.06.2022 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik ankimues “Malvina Visoka” pf mbi arsyet e skualifikimit me arsyetimin:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....., oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon: 1. OE nuk plotëson pikën 2.4.2 të DST, përkatësisht: 2.4.2 Operatori ekonomik duhet te paraqese Certificate Regjistrimi te Markes sipas objektit te prokurimit. KVO konstatoi se: OE “MALVINA VISOKA” PF nuk ka paraqitur Certificate Regjistrimi te Markes, kriter i cili është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST. Sqarojme se OE ka paraqitur në SPE një Certificate Marke, e cila nuk ka emer të operatorit ekonomik në të (dmth është e paidentifikueshme).

II.8. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 07.07.2022, operatori ekonomik “Malvina Visoka” pf ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij, si dhe kualifikimin e operatorit ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK.

II.8.1. Në ankesë ngrihen pretendime nga ana e operatorit ekonomik Malvina Visoka” pf si më poshtë vijon:

[...] Në datën 29.06.2022 ak ka publikuar renditjen ku ne jemi skualifikuar për mosplotësimin e kriterit 2.4.2. të dst të publikuar i cili thotë:

2.4.2 Operatori ekonomik duhet te paraqese Certificate Regjistrimi te Markes sipas objektit te prokurimit.

Në si oe pjesëmarrës kemi hedhur në SPE certifikatën e regjistrimit të markës për prodhuesin e detergjenteve që ne tregtojmë në Shqipëri si distributor i autorizuar lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Intelektuale në Shqipëri i cili është lëshuar më datë 05.04.2017 dhe ka një afat 10 vjeçar. Kjo certifikatë cakton një kod për markën i cili është unik dhe i pandryshueshëm për 10 vite. Kjo e dhënë është një e dhënë publike e cila mjafton të kërkosh në regjistrin elektronik të markave i cili shfaqet në faqen e DPPI-së.

Ak na ka skualifikuar me arsyetimin se certifikata e markës është e paidentifikueshme. Ak është e detyruar të bëjë verifikimin e plotë të të gjitha certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura nga oe-të për plotësimin e kriterëve. Po sikur oe të kishte paraqitur një certifikatë fallco të modifikuar? Si do e verifikonte AK origjinalitetin e saj?

Duke u futur në faqen zyrtare të DPPI dhe duke kërkuar regjistrin kombëtar të markave të regjistruara për kodin përkatës dhe verifikimin nëse i përket këtij oe. LPP-ja lejon AK të kërkojë informacione shitesë nga oe pjesëmarrës nëse një dokument i paraqitur në sistem është i paqartë. Në këtë rast AK duhet të kryej verifikime pasi certifikata e regjistrimit të markës në vetvete është një kod, një kod me të cilin në regjistrin kombëtar të markave tek faqja e DPPI dhe e verifikon se kujt i takon ca aktiviteti kryen subjekti dhe të gjitha karakteristikat e markës. Në këtë rast nuk është bërë asnjë verifikim nga ana e AK as tek faqja e DPPI e te regjistri i markave e as në kontakt me ne si ofertues për sqarimin e dokumentit. Për sa i përket kualifikimit të “Euro mega 2010” ShPK si oe fitues kemi dyshime të bazuara edhe në procedurën e mëparshme të anuluar dhe në mostra të paraqitura në procedura të tjera se ky oe nuk ka plotësuar kërkesat për artikujt nr. 5 19 dhe 21 të listës sipas shtojcës nr. 6.

Këto artikuj nuk përputhen me kërkesat e kërkuara në dst edhe pse mund të kenë paraqitur skedë teknike për këto produkte skedat teknike për kimikatet dhe detergjentet duhet të jenë të bazuara në fletë analizë ose testim laborator i miratuar.

Kemi bindjen që këto produkte nuk janë as në përputhje as me DST as me skedën e tyre teknike. Ne si oe për artikullin nr. 21 hipoklorit kalciumi Te jete klori aktiv 55-70%, plumbi (pb) 2.2, kadmiumi (cd), kromi (Cr) 1.7, nikeli (ni) 1.9, është paraqitur skeda teknike e bazuar në analizën e ISHP-së të cilat shoqërojnë mallin dhe vërtetojnë se skeda teknike është reale dhe jo e hartuar nga oe thjesht për të plotësuar specifikimet e tenderit.

Paraqitja e skedës teknike pa përputhje me cilësinë e produktit brenda ambalazhimit e vendos oe “Euro mega 2010” ShPK në kushtet e kryerjes së veprës penale të mashtrimit. Në veçanti hipoklorit kalciumi është kimikat i cili ka të bëjë drejtpërdrejt me shëndetin e njeriut. Duke qenë se procedura të tilla duhet vërtetuar cilësia e produkteve pasi ato ndikojnë drejtë për drejtë në shëndetin e titullarëve të institucionit dhe njerëzve të tjerë. Në mendojmë se duhet të verifikohet menjëherë cilësia dhe përputhshmëria e artikujve të dorëzuar në mostra nga oe “Euro mega 2010” ShPK.

Artikulli nr. 5 Detergjent neutral dyshemeje bidon 5 litra është produkt tepër i veçantë dhe delikat në formulë dhe është vështirë të gjendet një detergjent me fuqi larëse dhe me PH natural.

Duke marrë parasysh produktet që oe “Euromega 2010” ShPK prodhon dalim në konkluzion se është e pamundur të ketë prodhuar dhe dorëzuar një mostër me specifikat e kërkuara sipas kërkesës së AK. Gjithsesi ne si oe kemi dorëzuar mostrat sipas kërkesës dhe të shoqëruara me skedë teknike të mbështetur në fletë analiza. Për sa i përket artikullit nr. 19 detergjent universal (zbardhues) Te jete cilësor, me fuqi larese te njollave. Ambalazhimi 5lit , gjendja fizike te jete lëng. Të jete i tretshem ne uje. Te mos mbaje arome te forte dhe mos te demtoje lekuren e njeriut. Etiketimi ne perputhje me rregulloren CE , nr 1272/2008 te kete date prodhimi dhe date skadimi jo me pak se 1 vit (bidon 5 lit) OE “Euromega 2010” ShPK ka dorëzuar një produkt me bazë hipoklorit natriumi i cili është shumë i dëmshëm për lëkurën dhe për aparatën e frymëmarrjes. Ky produkt duhet të shoqërohet me skedën teknike të saj me pitogramën e rrezikshmërisë dhe shenjave parandaluese për rrezikshmërinë e saj gjatë përdorimit. Ndërkohë në DST kërkohen produkte të padëmshme për lëkurën dhe irritime të ndryshme që këto produkte mund të shkaktojnë. Oe “Euromega 2010” ShPK ka dorëzuar mostër totalisht në kundërshtim me kërkesat e AK. Nisur nga sa më sipër kërkojmë që këto produkte ti nënshtrohen dhe njëherë rivlerësimit të mostrave. Përbërësit e këtyre detergjenteve kanë miksime shumë të rrezikshme nëse nuk janë në parametrat e pranueshme dhe të kërkuara nga AK për këtë rast. [...]

II.9. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1456/2 datë 08.07.2022, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “Malvina Visoka” pf si dhe kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimes “Malvina Visoka” pf, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Euro mega 2010” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.10. Me shkresën nr.3006/24 prot., datë 19.07.2022, protokolluar me tonën nr.1456/3 prot., datë 21.07.2022, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, duke dërguar

pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin mbi procedurën e prokurimit objekt-ankimi dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Malvina Visoka” pf dhe ka vendosur mospranimin të ankesës.

II.11. Në datën 29.06.2022 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik ankimues LEON Group mbi arsyet e skualifikimit me arsyetimin:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: "Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se:, “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....., oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon: 1. OE nuk plotëson pikën 2.4.2 të DST, përkatësisht: 2.4.2 Operatori ekonomik duhet te paraqese Certificate Regjistrimi te Markes sipas objektit te prokurimit. KVO konstatoi se: OE “LEON GROUP” SHPK nuk ka paraqitur Certificate Regjistrimi te Markes, kriter i cili është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST.

II.12. Në datën 08.07.2022, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1483/2022 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2348 e operatorit ekonomik LEON Group duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.12.1. Në ankesë ngrihen pretendime nga ana e operatorit ekonomik LEON Group si më poshtë vijon:

Me date 09.06.2022, AK Bashkia Kurbin ka publikuar njoftimin e kontrates me Nr. REF-32147-06-08-2022, me objekt Blerje materiale pastrimi dhe detergjente, Bashkia Kurbin me fond limit 2,416,667 pa TVSH, parashikuar per t'u zhvilluar më datë 20.06.2022, ndersa me daten 04.07.2022 eshte publikuar njoftimi i fituesit dhe eshte vendosur skualifikimi i padrejte per OE Leon Group.

Autoriteti kontraktor Bashkia Kurbin ka skualifikuar ne menyre te padrejte operatorin ekonomik Leon Group ShPK, me numer nipt-i L51313013I, pasi OE Leon Group SH.P.K ka permbushur te gjitha kriteret e pergjithshme edhe te vecanta te kualifikimit.

Lidhur me arsyet e skualifikimit Autoriteti Kontraktor nuk ka zbatuar parashikimet e LPP 162/2020

si me poshte vijon:

Referojmë nenin 2 të LPP-së Nenin 3 [...]

Si dhe duke marre ne konsideratë frymën e legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që ti shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, te cilet OE Leon Group ShPK, i ka permbushur sipas DST-se se publikuar ne SPE nga Autoriteti Kontraktor. Autoriteti Kontraktor ne kriterin 2.4.2, per te cilin ka skualifikuar OE Leon Group ShPK, kerkohet:

2.4.2 Operatori ekonomik duhet te paraqese Certifikate Regjistrimi te Markes sipas objektit te prokurimit.

Leon Group si operator pjesëmarrës te cilit i jane cenuar te drejtat e tij, thekson se per plotesimin e ketij kriteri duhet te paraqitet certifikata e konformitetit e cila eshte i vetmi dokument zyrtar qe shoqeron mallin dhe provon se ky mall eshte sipas standardeve kombetare ose nderkombetare, pasi bazuar edhe ne Direktivat e Bashkimit Europian, prodhuesit janë përgjegjës për sigurimin e konformitetit të produktit dhe marrjen e Certifikatës CE, por importuesit duhet të sigurojnë që produktet që vendosen në treg të përputhen me kushtet e aplikueshme ne aspektin e sigurisë, shëndetit dhe mbrojtjes së mjedisit, prandaj për këtë qëllim, importuesit duhet të verifikojnë që prodhuesit Brenda apo jashtë Bashkimit Europian kanë marrë Certifikatën e konformitetit CE. Per me teper OE Leon Group per te bindur Bashkine Kurbin qe mallrat jane sipas specifikimeve teknike, ka paraqitur mostrat e kerkuara ditën e hapjes se ofertave te cilat kane rezultuar ne perputhje me specifikimet teknike. Po ashtu rithekojme se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar nje panorama të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës te cilen OE Leon Group e ka provuar me dokumentacion ne SPE dhe me paraqitjen fizikisht te mostrave. Bashkia Kurbin ka te gjitha garancite ligjore per te kontrolluar cilesine e mallit gjate zbatimit te kontrates, pasi referuar rregullave të prokurimit publik është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’iu siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. Si perfundim kerkojme shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik Leon Group SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit dhe kualifikimin e ofertes se paraqitur nga OE LEON GROUP SHPK.[...]

II.13. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1483/2 datë 12.07.2022, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimes LEON Group në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.14. Me shkresën nr.3006/26 prot., datë 19.07.2022, protokolluar me tonën nr.1483/3 prot., datë 21.07.2022, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, duke dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin mbi procedurën e prokurimit objekt-ankimi dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues LEON Group dhe ka vendosur mospranimin të ankesës.

II.15. Në datën 29.06.2022 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik ankimues “Anbim” ShPK mbi arsyet e skualifikimit me arsyetimin:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit ..., si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....., oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon: 1. OE nuk plotëson pikën 2.4.2 të DST, përkatësisht: 2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certificate Regjistrimi të Markes sipas objektit të prokurimit. KVO konstatoi se: OE “ANBIM” SHPK nuk ka paraqitur Certificate Regjistrimi të Markes në emër të tij, kriter i cili është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST. Sqarojmë se përderisa OE deklaron që është vetë prodhues i detergjenteve edhe certifikatën e markes duhet ta dispononte në emër të tij. 2. Gjithashtu dokumentacioni që OE “ANBIM” SHPK ka paraqitur për pikën 2.6 të DST, nuk është bindës pasi: Ka deklaruar se OE është vetë prodhues i detergjenteve si dhe ka paraqitur certifikatë konformiteti dhe Skeda Teknike të plotësuara nga vetë OE, por nuk disponon Certificate Regjistrimi të Markes në emër të tij.

II.16. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 12.07.2022, operatori ekonomik “Anbim” ShPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij, nga procedura e mësipërme e prokurimit.

II.16.1. Në ankesë ngrihen pretendime nga ana e operatorit ekonomik “Anbim” ShPK si më poshtë vijon:

[...]Në mbështetje të nenin 92 pika 3 e LPP-së referojmë nenin[...].

Oferta jonë refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

1. OE nuk plotëson pikën 2.4.2 të DST, përkatësisht: 2.4.2 Operatori ekonomik duhet te paraqese Certificate Regjistrimi te Markes sipas objektit te prokurimit. KVO konstatoi se: OE "ANBIM" SHPK nuk ka paraqitur Certificate Regjistrimi te Markes në emër të tij, kriter i cili është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST. Sqarojmë se përderisa OE deklaroi që është vetë prodhues i detergjenteve edhe certifikatën e markes duhet ta dispononte në emër të tij. 2. Gjithashtu dokumentacioni që OE "ANBIM" SHPK ka paraqitur për pikën 2.6 të DST, nuk është bindës pasi: Ka deklaruar se OE është vetë prodhues i detergjenteve si dhe ka paraqitur certifikatë konformiteti dhe Skeda Teknike të plotësuar nga vetë OE, por nuk disponon Certificate Regjistrimi te Markes në emër të tij.

Referojmë kriterin që kërkohet në dst[...]

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në LPP dhe nenin 40 pika 8 të VKM-së [...]

Për garantimin e cilësisë shërben certifikata ISO dhe vendosja e këtij kriteri mbështetet drejt në nenin 44 pika 1 dhe 3 e Vkm-SË[...].

Çfarë është një markë tregtare apo një markë shërbimi?

Marka është fjalë simbol vizatim apo kombinim i disa fjalëve i frazave simboleve apo vizatimeve që identifikojnë dhe dallojnë burimin e mallrave të një pale nga ato të një pale tjetër. Kjo do të thotë që ky kriter nuk garanton cilësinë por garanton burimin e mallrave.

Deklarata noteriale midis shoqërisë Miqësia ShPK pronare e markës Epta dhe shoqërisë Anbim ShPK që është pjesë integrale e dokumenteve në SPE i jep të drejtën kësaj të fundit të prodhojë produktet me markën Epta për një periudhë 3 vjeçare.

Kjo do të thotë që burimi i mallrave që do të furnizohen për AK është plotësisht i përcaktuar dhe kriteri i vendosur plotësohet më së miri dhe ne mendojmë që KVO nuk ka vepruar në skualifikimin e ofertës tonë bazuar në këtë kriter.

Në pikën 2.6. të procesverbalit të argumentimit dhe të DST. 2.6.[...] Kjo do të thotë që skedat teknike hartohen nga prodhuesi dhe në rastin konkret prodhues është Anbim ShPK prandaj dhe i ka hartuar. Çfarë janë skedat teknike? Skedat teknike janë përmbledhje të treguesve fizik kimik dhe të ambalazhimit të një produkti që shërbejnë për të gjykuar cilësinë e produktit. Këto tregues i paraqet saktë ai që e prodhon produktin dhe ai që është i ngarkuar me ligj për këtë qëllim ligji për detergjentet 10216 dt. 21.10.2010.

Certifikata e konformitetit

Bazuar në paragrafin e mësipërm të DST do të thotë që certifikatat e konformitetit hartohen nga prodhuesi dhe në rastin konkret prodhues është Anbim ShPK prandaj dhe ai i ka hartuar.

Çfarë janë certifikatat e konformitetit

Certifikata e konformitetit është një certifikatë që u jepet produkteve që plotësojnë një grup të kërkesave të sigurisë rregullave lokale dhe nacionale dhe teknike. Certifikatat e konformitetit mund të ndryshojnë në gjithë botën kështu që prodhuesit e produkteve të shitura ndërkombëtarisht duhet të jenë të vetëdijshëm për standardet e ndryshme që duhet të respektojnë. Këto tregues i paraqet saktë ai që e prodhon produktin dhe ai që është i ngarkuar me ligj për këtë qëllim ligji për detergjentet 10216 dt. 21.10.2010.

Shoqëria Anbim ShPK mendon se skualifikimi i saj për arsyet e sipërpërmendura më lart është jo i drejtë prandaj kërkon rishikimin e vendimit të KVO-së dhe kualifikimin e ofertës së tij.

Gjithashtu vëmë në dukje se oferta e shoqërisë Anbim ShPK 1.457.750 lekë; Shoqëria Euromega 2010 e ka ofertën 1.990.000 lekë. Krahasimi i këtyre dy ofertave tregon se oferta e Euromega 2010 ShPK është më e madhe se 532.250 lekë ose 36.51% më e lartë. [...]

II.17. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1488/2 datë 13.07.2022, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Anbim” ShPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.18. Me shkresën nr.3006/25 prot., datë 19.07.2022, protokolluar me tonën nr.1488/4 prot., datë 21.07.2022, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, duke dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin mbi procedurën e prokurimit objekt-ankimi dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezultoi, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Anbim” ShPK dhe ka vendosur mospranimin të ankesës.

II.19. Me shkresën protokolluar me tonën me nr. 1488/3 prot, datë 15.07.2022, operatori ekonomik ankimues “Anbim” ShPK ka depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik bashkëlidhur dokumentacion për procedurën e objekt-shqyrtimi.

II.20. Me shkresën nr. 1456/4 prot datë 05.08.2022 me lëndë “Kërkesë për informacion” drejtuar Bashkisë Kurbin, Komisioni i Prokurimit Publik kërkoi mostrat e paraqitura si dhe dokumentacionin shoqërues për këtë procedurë prokurimi nga ana e operatorit ekonomik “Euromega” ShPK.

II.21. Me shkresën nr.4171/1 prot., datë 10.08.2022, protokolluar me tonën nr.1456/5 prot., datë 10.08.2022, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik mostrat si dhe dokumentacionin e kërkuar nga ky i fundit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorëve ekonomikë “Malvina Visoka” pf, “LEON Group” ShPK dhe “Anbim” ShPK në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, në të cilin parashikohet se “*1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përbërësit, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre*”, nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorëve ekonomikë ankimes, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.1. Lidhur me pretendimet e operatorëve ekonomikë “Malvina Visoka” pf, “LEON Group” ShPK dhe “Anbim” ShPK mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit së tyre se “*OE nuk plotëson pikën 2.4.2 të DST, përkatësisht: 2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë Regjistrimi të Markës sipas objektit të prokurimit.*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.2. Në shtojcën 7 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, në pikën 2.3. “*Kapacitetin teknik*” 2.4 “*Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim*” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:
2.4.2 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë Regjistrimi të Markës sipas objektit të prokurimit.*

III.1.3. Në nenin 2 “*Qëllimi*” të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet shprehimisht se: “*Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “*Parime të përgjithshme*” të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet shprehimisht se:

“*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.4. Në nenin 77, pikat 1, 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.5. Në nenin 40 pika 3 dhe 5 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet se:

3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo 38 rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të

përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

III.1.6. Në nenin 44 pika 1 “Kërkesat e Cilësisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet se:

Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, **gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit**, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik **duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik**. Lidhur me kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor, se *Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë Regjistrimi të Markës sipas objektit të prokurimit*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementeve kryesore, së pari nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, KPP gjykon të ndalet

edhe në faktin, nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 të ligjit 162/2020 Për prokurimin Publik.

Referuar objektit të prokurimit, në rastin konkret, i cili është blerje materiale pastrimi dhe detergjente, vlerës dhe përmasave të kontratës, akoma më tej rëndësisë së saj, KPP gjykon, se në procedurën e prokurimit objekt-ankimi kriteri i vendosur lidhur me certifikatën e regjistrimit të markës, është një kriter i ekzagjeruar, diskriminues, i panevojshëm dhe jo në përputhje me natyrën e kontratës. Vendosja e këtij kriteri rëndon pozitën e operatorëve ekonomikë në mënyrë të panevojshme me një kriteri i cili nuk i shërben qëllimit dhe realizimit të objektit të prokurimit. KPP gjykon, se kërkesat kualifikuese të procedurës së prokurimit duhet të përcaktohen, të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim kryerjen e një vlerësimi të drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi. Vendosja e kriterëve të ekzagjeruara që nuk kanë lidhje me natyrën e kontratës, shkel parimin e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, nxitjes së konkurrencës dhe pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit. KPP gjykon, se kriteri i veçantë i kualifikimit i sipërcituar, ka shkelur parimin e barazisë dhe pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, duke shkaktuar skualifikim të padrejtë në radhët e operatorëve ekonomikë ankimues nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, duke i detyruar këta të fundit t'i përmbahen një kriteri diskriminues, të panevojshëm, i cili tejkalon kufijtë maksimalë të parashikuar nga ligji për prokurimin publik. KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Në rastin konkret procedura është zhvilluar duke vendosur kriterë diskriminuesë duke shkelur parimet dhe qëllimet e vendosura në ligj.

Sa më sipër, KPP gjykon, se situata e krijuar nga përcaktimi i kriterit të ekzagjeruar në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, përbën shkak për anulimin e procedurës në kuptim të nenit 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, *Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenin 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.*

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Atlantik 3” ShPK mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Euromega 2010” ShPK, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar gjykimit më sipër gjykon, se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi,

procedura e prokurimit objekt-ankimi do të anulohet e rrjedhimisht duke mos pasur asnjë ndikim mbi fatin e çështjes objekt-ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë “Malvina Visoka” pf, “LEON Group” ShPK dhe “Anbim” ShPK, për procedurën e prokurimit E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-32147-06-08-2022, me objekt: “Blerje materiale pastrimi dhe detergjente, Bashkia Kurbin”, me fond limit 2,416,667 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 20.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kurbin.
2. Të mos marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Atlantik 3” ShPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë ankimues “Malvina Visoka” pf, “LEON Group” ShPK dhe “Anbim” ShPK, “Atlantik 3” ShPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri